



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Gjykata Kushtetuese / Ustavni sud / Constitutional Court

Prishtinë, 15 tetor 2010
Nr. ref.: RK 48/10

VENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI 17/10

Vesel Tmava dhe të tjerët

kundër

Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit të Republikës së Kosovës

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbëre nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesit e kërkesës

1. Parashtruesi quhet Vesel Tmava, qytetar i Kosovës me banim në Llugaxhi të Komunës së Lipjanit, së cilët i bashkohet një grup i qytetarëve të ndikuar në mënyrë të ngjashme. Parashtruesit kolektivisht përfaqësohen nga Z. Naser Gashi, avokat nga Prishtina.

Pala kundërshtare

2. Pala kundërshtare është Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit e Republikës së Kosovës (në tekstin e më tutjeshëm "Ministria").

Objekti i çështjes

3. Parashtruesit pretendojnë që Udhëzimi Administrativ i Ministrisë (në tekstin e mëtutjeshëm "Udhëzimi"), i nxjerrë më 01 janar 2009, shkel të drejtën e pronës.

Baza juridike

4. Neni 113 (7) i Kushtetutës, Nenet 20 dhe 22 (7) dhe (8) të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i datës 16 dhjetor 2008, (në tekstin e mëtutjeshëm "Ligji") dhe Neni 54 (b) i Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtutjeshëm "Rregullorja e Punës").

Përmbledhje e Procedurës para Gjykatës

5. Parashtruesit kanë dorëzuar Kërkesën në Gjykatë më 11 shkurt 2010.
6. Më 2 mars 2010, Gjykata ia ka dërguar një kopje të kërkesës Ministrisë dhe ka kërkuar përgjigje nga ajo. Gjykata ka pranuar përgjigjen e Ministrisë më 8 mars 2010.
7. Më 14 prill 2010, Gjykata ia ka dërguar një kopje të përgjigjes të Ministrisë përfaqësuesit ligjor të Parashtruesve dhe ka ftuar përfaqësuesin ligjor të ofrojë komentet e tij për përgjigjen e Ministrisë. Përfaqësuesi ligjor i Parashtruesve, megjithatë, nuk iu ka përgjigjur kërkesës.
8. Më 14 qershor 2010, Kolegji Shqyrtues i përbërë nga Gjyqtarët Robert Carolan (Kryesuesi), Enver Hasani dhe Ivan Cukalovic kanë shqyrtuar raportin e Gjyqtarit Raportues Almiro Rodrigues dhe i kanë ofruar një rekomandim Gjykatës në lidhje me papranushmërinë e Kërkesës.

Faktet

9. Parashtruesit janë pronarë të automjeteve që kanë timonin në anën e djathtë të automjetit. Këto automjete kryesisht janë importuar nga Britania e Madhe. Parashtruesit kanë paguar detyrimet doganore për automjetet dhe secili prej tyre ka marrë një Dokument Unik Doganor. Automjetet po ashtu i janë nënshtruar kontrollit teknik dhe janë regjistruar në Qendrën për Regjistrimin e Automjeteve.
10. Më 1 janar 2009, Ministria ka lëshuar Udhëzimin e atakuar që obligon homologimin e automjeteve për trafikun rrugor në Kosovë (Pjesa hyrëse e Udhëzimit Administrativ Nr. 2008/08).
11. Në mënyrë që të standardizonte procesin e përcaktuar me Udhëzim, Ministria më 24 qershor 2009 miratoi Vendimin Nr. 303/09 (në tekstin e mëtutjeshëm "Vendimi"), i cili përcakton që të gjithë personat, që janë pronarë të automjeteve të destinuara për tregjet e Britanisë së Madhe, Qipros apo Maltës, duhet të "marrin një certifikatë të përshtatshmërisë nga një institucion i autorizuar në Republikën e Kosovës" (Vendimi nr. 303/09, paragrafi 4). Ky vendim ka hyrë në fuqi më 1 korrik 2009 (Vendimi nr. 303/09, paragrafi 5).

Pretendimet e parashtruesve

12. Parashtruesit ankohen që ata nuk do të jenë në gjendje të marrin një certifikatë të përshtatshmërisë për automjetet e tyre me timon në anën e djathtë, dhe që prandaj,

kushtet e reja zbatohen retroaktivisht për të gjitha automjetet e regjistruara para datës 1 korrik 2009.

13. Parashtruesit pohojnë që një efekt i tillë rektroativ nuk është paraparë as me Ligjin Nr. 02/L-70 për Sigurinë në Komunikacionin Rrugor (Nr. 02/L-70) e as me Udhëzim.
14. Prandaj parashtruesit pretendojnë që Vendimi i deprimon ata nga ushtrimi i së drejtës në pronë, të garantuar me Nenet 46.1 dhe 46.2 të Kushtetutës. Për të njëjtat arsye, Parashtruesit pretendojnë që Vendimi shkel Nenin 3 (2) [Barazia para Ligjit], Nenin 16 (1) [Epërsia e Kushtetutës], Nenin 24 (1) dhe (2) [Barazia para Ligjit], dhe Nenin 55 (1) [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] të Kushtetutës.
15. Për shkak të numrit të madh të automjeteve me timon në anën e djathtë në Kosovë, Parashtruesit po ashtu pohojnë që zbatimi i Udhëzimit dhe i Vendimit “mund të shkaktojë dëm të pariparueshëm” dhe që, si pasojë, interesi publik detyron Gjykatën të parandalojë një dëm të tillë.
16. Prandaj Parashtruesit kërkojnë që Gjykata të shqiptojë masën e përkohshme sipas nenit 116 (2) të Kushtetutës dhe Nenit 27 (1) të Ligjit, Më konkretisht, Parashtruesit kërkojnë që Gjykata “të pezullojë kapacitetin retroaktiv” të Vendimit dhe të Udhëzimit përderisa Gjykata të mos vendos për meritat e këtij rasti.

Pretendimet e Palës kundërshtare

17. Në përgjigjen e saj, Ministria pohon që “Vendimi nuk ka bazë ligjore retroaktive” (Përgjigja, Nr. i Referencës 50508, më 8 mars 2010, paragrafi 12) dhe që prekë vetëm automjetet e regjistruara pas datës 1 korrik 2009.
18. Ministria pranon që pronarët e automjeteve me timon në anën e djathtë, që janë regjistruar para datës 1 korrik 2009, megjithatë duhet të marrin një certifikatë të përshtatshmërisë para përtëritjes së regjistrimit të këtyre automjeteve (Përgjigja, Nr. i Referencës 50508, më 8 mars 2010, paragrafi 12). Ministria instiston që marrja e një certifikate të tillë nuk obligon pronarët të kthejnë automjetet në fjalë në vendin e tyre të origjinës (Përgjigja, Nr. i Referencës 50508, më 8 mars 2010, paragrafi 13). Në vend të kësaj, Ministria trimëron pronarët “të gjejnë një zgjidhje teknike” që do mundësonte ndërrimin e vendit të timonit në anën e majtë të automjetit (Përgjigja, Nr. i Referencës 50508, më 8 mars 2010, paragrafi 12).
19. Ministria pohon që legalizimi i automjeteve me timon e anën e djathtë do të paraqiste “rrezik të përhershëm për shoferët e këtyre automjeteve dhe pjesëmarrësve tjerë në komunikacionin rrugor” (Përgjigja, Nr. i Referencës 50508, më 8 mars 2010, paragrafi 10). Ministria është posaqërisht e shqetësuar që shenjat e trafikut nuk janë të vendosura në atë mënyrë për të akomoduar shoferët e automjeteve me timon në anën e djathtë (Përgjigja, Nr. i Referencës 50508, më 8 mars 2010, paragrafi 11). Për këto arsye, Ministria beson që në fakt interesi publik shkon në favor të Vendimit.

Vlerësim i kërkesës për Masa të Përkohshme

20. Parashtruesit as nuk përcaktojnë arsyet për masë të përkohshme e as nuk precizojnë pasojat nëse një masë e tillë nuk miratohet. Prandaj argumentet e paraqitura nga Parashtruesit nuk përmbushin dispozitën kushtetuese për “dëm të pariparueshëm” (Neni 116 (2) i Kushtetutës).
21. Si rrjedhojë, kërkesa për masa të përkohshme është e pabazë dhe duhet të refuzohet si e papranueshme.

Vlerësimi i pranueshmërisë së Kërkesës

22. Në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë për Kërkesën e Parashtruesve, Gjykata së pari duhet të kontrollojë nëse Parashtruesit kanë përmbushur kushtet e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë.
23. Neni 113 (7) i Kushtetutës përcakton që:
- “Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”*
24. Neni 47.2 i Ligjit përcakton që:
- “Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”*
25. Parashtruesit e kërkesës pranojnë që “gjykatat e rregullta nuk kanë filluar procedurat në asnjë rast (...) për shkak se autoritetet nuk kanë lëshuar ndonjë vendim refuzues për palët (...) nëpërmjet Qendrave për Kontroll Teknik.”
26. Gjykata dëshiron të theksojë që arsyeja për rregullin e shterimit të mjeteve juridike është t’u ofrojë autoriteteve në fjalë, përfshirë gjykatat, mundësinë për të parandaluar apo konfirmuar shkeljen e supozuar të Kushtetutës. Rregulli është i bazuar në supozimin që rendi juridik në Kosovë do të ofrojë mjete efektive juridike për shkeljen e të drejtave kushtetuese (*Shih, në mënyrë të përshtatshme, GJEDNj, Selmouni kundër Francës, nr. 25803/94, vendim i datës 28 korrik 1999*). Megjithatë, nuk është e domosdoshme që të drejtat kushtetuese shprehimisht të parashtrohen në procedurat në fjalë. Përderisa çështja parashtrohet në substancë apo në mënyrë të vetëkuptueshme, kushti për shterimin e mjeteve juridike përmbushet (*Shih, në mënyrë të përshtatshme, GJEDNj, Azinas kundër Qipros, nr. 56679/00, vendim i datës 28 prill 2004*).
27. Megjithatë, Parashtruesit pohojnë që procedura të tilla gjyqësore, pasi që të nisen, zgjasin tri deri në pesë vite për shkak të ngarkimit të gjykatave me raste të ndryshme. Parashtruesit pretendojnë që pasi të kalojnë tri vite, atyre do t’u kërkohej ndërrimi i anës së timonit të automjeteve të tyre. Për këto arsye, Parashtruesit pohojnë që atakimi i Udhëzimit nëpërmjet procedurave të rregullta gjyqësore do të ishte i “paarsyeshëm” dhe nuk do të përmbante “ndonjë vlerë juridike”.
28. Për shkak “se atyre u kërkohet vetëm shterimi i mjeteve juridike efektive dhe në dispozicion” (*Vendim, Rasti Nr. KI 23/09, Ahmet Arifaj kundër Komunës së Klinës, paragrafi 13*), Parashtruesit pretendojnë që Gjykata duhet të konsiderojë Kërkesën si të pranueshme.
29. Gjykata thekson që Parashtruesit e pranojnë që nuk kanë atakuar as Udhëzimin e as Vendimin nëpërmjet procedurave të rregullta administrative apo gjyqësore. Gjykata po ashtu thekson që Parashtruesit nuk kanë kërkuar mbrojtje juridike nëpërmjet ndonjë mjeti tjetër juridik që do të mund të ishte në dispozicion në bazë të ligjeve të zbatueshme.
30. Në fakt, Parashtruesit kanë pasur mjete tjera juridike edhe para se autoritetet të kenë lëshuar refuzimet në lidhje me regjistrim, për shkak se Ligji për Procedurën Administrative përfshinë mënyrat e ankesës për heshtjen administrative.

31. Në vend të kësaj, Parashtruesit drejtpërdrejt kanë parashtruar kërkesën në Gjykatën Kushtetuese me pretendimin që mjetet juridike në dispozicion ishin joefektive. Megjithatë, Parashtruesit e kërkesës së pari do të duhej të përpiqeshin të kërkojnë mbrojtje juridike nëpërmjet mjeteve juridike në dispozicion, para se të konstatojnë që mjete të tilla juridike janë joefektive. Pretendimi abstrakt që mjetet juridike janë joefektive nuk përmbush kriterin për shterimin e mjeteve juridike.
32. Si pasojë, Gjykata gjen se Parashtruesit nuk kanë përmbushur kushtin për shterimin e të gjitha mjeteve juridike të përcaktuar me ligj sipas Nenit 113 (7) të Kushtetutës.

PËR KËTO ARSYE

33. Në mbështetje të Nenit 27 (1) dhe 47 të Ligjit, dhe Nenit 52 (1) dhe 55 të Rregullores së Punës, Gjykata Kushtetuese në seancën e datës 15 tetor 2010, me SHUMICË VOTASH:

VENDOS

- I. TA REFUZOJ kërkesën për masa të përkohshme.
- II. TA REFUZOJ Kërkesën si të Papranueshme.
- III. Në pajtim me Nenin 20 (4) të Ligjit, ky Vendim do t'iu komunikohet Palëve dhe do të shpallet në Gazetën Zyrtare.
- IV. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari Raportues

Almiro Rodrigues, d.v.



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. Dr. Enver Hasani, d.v.